

TRANSFORMIMI DIGJITAL NË ARSIM TË LARTË – PERSPEKTIVAT RINORE



**Analizë për digjitalizimin e shërbimeve
në arsimin e lartë në Maqedoninë e Veriut**

Transformimi digjital në arsim të lartë – perspektivat rinore. Analiza e digjitalizimit të shërbimeve në arsimin e lartë në Maqedoninë e Veriut

Botues: Instituti për Qeverisje të Mirë dhe Perspektiva Euro-Atlantike, Bul. Koço Racin nr.40/11, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut, www.iduep.org.mk

Autor: Bojan Kordalov, Instituti për Qeverisje të Mirë dhe Perspektiva Euro-Atlantike

Redaktor: Bojan Kordalov

Dizajni: Bojan Ivanovikj

Наслов на оригиналот: Дигитална трансформација во високото образование – Младински перспективи

Анализа за дигитализација на услугите во високо образование во Северна Македонија

Пërкthim nga maqedonishtja në shqip : Eniena Aeti

Shkup, 2023

Е drejta e autorit © 2023 Instituti Republikan Ndërkombëtar

Тë gjitha të drejtat e rezervuara.

Deklarata e lejes: Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet në asnjë formë ose me çfarëdo mjeti, elektronik ose mekanik, duke përfshirë fotokopjimin, regjistrimin ose ruajtjen në sisteme ruajtjeje ose për kërkim të informacioneve, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Institutit Republikan Ndërkombëtar.

Кërkesat për leje duhet të përfshijnë informacionin e mëposhtëm:

- >>> Emri i dokumentit për të cilin kërkohet leja për të kopjuar materialin.
- >>> Përshkrim i materialit për të cilin kërkohet leja për të kopjuar.
- >>> Qëllimi për të cilin do të përdoret materiali i kopjuar dhe mënyra se si do të përdoret.
- >>> Emri juaj, titulli i punës, emri i kompanisë ose organizatës, numri i telefonit, faksi, adresa e postës elektronike dhe adresa postare

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

004.67-043.72:378(4977)(036)

KORDALOV, Bojan

Transformimi digjital në arsim të lartë – perspektivat rinore [Електронски извор] : analiza e digjitalizimit të shërbimeve në arsimin e lartë në Maqedoninë e Veriut / [autor Bojan Kordalov ; përkthim nga maqedonishtja në shqip Eniena Aeti]. - Shkup : Instituti për qeverisje të mirë dhe perspektiva euro-atlantike, 2023

Начин на пристапување [URL: https://iduep.org.mk/2023/04/05/neahtiven-link-4/?fbclid=IwAR2qApOnYIN9syzmTizCXzu_V7t_ITk266ZIEIztwBc8-BWV3N2hllKAwM]. - Превод на делото: Дигитална трансформација во високото образование : младински перспективи : анализа за дигитализација на услугите во високо образование во Северна Македонија. - Текст во PDF формат, содржи 20 стр., илустр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 18.04.2023. - Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 19

ISBN 978-608-66841-4-3

1. Гл. ств. насл.

а) Дигитална трансформација -- Виско образование -- Македонија -- Водичи

COBISS.MK-ID 60094725

Ky produkt është përgatitur nga Instituti për Qeverisje të Mirë dhe Perspektiva Euro-Atlantike (IDUEP) për Institutin Ndërkombëtar Republikan (IRI) në kuadër të programit "Institut për Udhëheqje Politike të Avancuar" (ALPI) me mbështetjen financiare të Departamentit të Shtetit të SHBA-së.

Autori është përgjegjës për përmbajtjen dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pozicionet e Institutit Republikan Ndërkombëtar (IRI) dhe Departamentit të Shtetit të SHBA-së.

PËRMBAJTJA

Hyrje	5
1. Transformimi digjital i shërbimeve studentore dhe mësimdhënies: situata dhe nevojat.....	7
2. Sfidat dhe pengesat në transformimin digjital të institucioneve të arsimit të lartë	11
I. Sistemi informativ i vjetërsuar.....	11
II. Mungesa e IT mbështetjes dhe menaxhimit	11
III. Vështirësia për të pranuar ndryshime (faktori njerëzor).....	12
IV. Mungesa e aftësive të nevojshme.....	12
V. Burimet financiare të ndara në mënyrë të pamjaftueshme	13
VI. Mungesë ose strategji dhe plane veprimi të papërshtatshme për digjitalizim	14
VII. Mospranimi i kërkesave dhe mosplotësimi i pritshmërive të studentëve.....	14
3. Përfundimet e analizës	15
4. Rekomandime për transformim digjital të suksesshëm të institucioneve të arsimit të lartë.....	16
I. Rekomandime për institucionet e arsimit të lartë dhe menaxhmentin e tyre, profesorët dhe zyrtarët administrativë të përfshirë në analizë	
II. Rekomandime për studentët dhe organizatat studentore nga universitetet e synuara	
III. Rekomandime për qeverinë dhe institucionet kompetente për arsimin e lartë.....	17
Bibliografia dhe dokumentet e përdorur:.....	19
Shtojca I: intervista të thelluara të realizuara.....	20

AKRONIMET

IAL	Institucione të arsimit të lartë
IT	Teknologjitë e Informacionit
TIK	Teknologjitë e Komunikimit të Informacionit
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MIOA	Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë
MF	Ministria e Financave
IRI	Instituti Republikan Ndërkombëtar
ALPI	Instituti për Udhëheqje të Avancuar
UKIM	Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi” - Shkup
UGD	Universiteti “Goce Dellçev” - Shtip
Universiteti EJL	Universiteti i Evropës Juglindore - Tetovë
USS UKIM	Asambleja Studentore Universitare në Universitetin “Shën Kirili dhe Metodi” - Shkup
IDUEP	Instituti për Qeverisje të Mirë dhe Perspektiva Euro-Atlantike
FOP	Forumi për ndryshime arsimore

Iniciativa "Transformimi digjital në arsim të lartë – perspektivat rinore" u zbatua nga anëtarët e gjeneratës së parë të Institutit të Udhëheqësisë së Avancuar (ALPI), të Institutit Republikan Ndërkombëtar (IRI): Arta Qerimi, Hilal Beqiri, Bojan Nikovski, Aleksandar Trajanovski, Naum Lokoski dhe Evgenija Janakieska.

Kjo iniciativë ka për qëllim ngritjen e vetëdijes për nevojën e digjitalizimit të shërbimeve për studentët në tre universitete në Republikën e Maqedonisë së Veriut: Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, Universiteti i Evropës Juglindore – Tetovë dhe Universiteti „Goce Dellçev“ në Shtip. Fokusi i nismës është shkëmbimi i përvojave mes universiteteve, si dhe nxitja e dialogut për transformimin digjital midis rektorëve, studentëve dhe parlamenteve studentore të universiteteve të synuara. Duke pasur parasysh se digjitalizimi i arsimit të lartë në vendin tonë është në fillimet e tij, kjo analizë synon të mbledhë përvojat nga procesi i zbatimit të vetë digjitalizimit, të zbulojë dobësitë dhe pikat e forta, si dhe të japë rekomandime për hapat e ardhshëm drejt vendosjes së një digjitalizimi plotësisht efektiv në arsimin e lartë.

Në kuadër të nismës "Transformimi digjital në arsim të lartë – perspektivat rinore", anëtarët e ALPI, në periudhën nëntor-dhjetor 2022, zhvilluan takime me përfaqësues të administratave rektorale të të tre universiteteve: prof. Dr. Hristina Spasevska, prorektore për mësimdhënie në Universitetin "Shën Kirili dhe Metodi" – Shkup, prof. Dr. Dejan Mirakovski, dekan i Universitetit „Goce Dellçev“ – Shtip, prof. Dr. Adrian Besimi, prorektor për planifikim akademik dhe digjitalizim në Universitetin e Evropës Juglindore – Tetovë, si dhe me personat përgjegjës për zbatimin e procesit të transformimit digjital, me qëllim të përcaktimit të gjendjes aktuale në këtë fushë në secilin universitet individualisht. Gjithashtu, në periudhën janar-shkurt 2023, u realizuan 9 intervista të thelluara, pra 3 brenda çdo universiteti (Shtojca I). Intervistat u kryen sipas një pyetësori të sistemuar dhe të unifikuar që mbulonte çështjet përkatëse lidhur me procesin e transformimit digjital në arsimin e lartë, të ndarë në dy segmente:

- 1) shërbime digjitale; dhe
- 2) mësimdhënie digjitale.

Grupi i synuar i intervistave përfshinte:

- 1) përfaqësuese dhe përfaqësues të administratave rektorale dhe persona përgjegjës për digjitalizim në 3 universitete;
- 2) kryetarët dhe kryetaret e parlamenteve studentore në këto universitete;
- 3) studentë/e nga të tre universitetet, nga fakultetet e teknologjisë së informacionit.

Dokumenti është përgatitur në bazë të një analize cilësore të përgjigjeve nga intervistat dhe takimet e realizuara, si dhe në bazë të një hulumtimi në zyrë të dokumenteve krahasuese dhe artikujve publikë mbi temën e digjitalizimit në arsimin e lartë në Maqedoninë e Veriut.

Kjo analizë dhe rekomandimet që rrjedhin prej saj dhe që i referohen zbatimit të një transformimi të qëndrueshëm digjital në arsimin e lartë u dedikohen të gjithë atyre që preken në këtë proces. Analiza do të jetë publikisht në dispozicion në faqen e internetit dhe në mediat sociale të Institutit për Qeverisje të Mirë dhe Perspektiva Euro-Atlantike (IDUEP), dhe gjithashtu do t'u shpërndahet universiteteve të synuara, organizatave studentore dhe organizatave të shoqërisë civile që punojnë në programe që kanë të bëjnë me digjitalizim dhe avancim të arsimit.



1. Transformimi digjital i shërbimeve studentore dhe mësimdhënies: situata dhe nevojat

Ekzistojnë përkufizime të ndryshme për termin “digjitalizim”, por më së shpeshti përkufizohet si përdorimi i teknologjive digjitale për të përmirësuar dhe ndryshuar modelin e biznesit dhe për të ofruar të ardhura dhe mundësi të reja për prodhim të vlerës, domethënë procesi i kalimit në një biznes digjital.¹ Rrjedhimisht, transformimi digjital mund të nënkuptojë gjithçka nga modernizimi i TI-së (p.sh. përdorimi i sistemeve cloud²) deri te gjetja e modeleve të reja digjitale të biznesit. Termi përdoret gjerësisht edhe në sektorin publik ku zakonisht u referohet nismave modeste si futja e shërbimeve online në nivel lokal ose qendror (p.sh. pagesa e taksave) dhe të ngjashme.

Në këtë kontekst, transformimi digjital në arsimin e lartë i referohet ndryshimit organizativ të realizuar me ndihmën e teknologjive digjitale dhe modeleve të biznesit për të përmirësuar performancën operationale të institucionit. Me fjalë të tjera, është transformimi i të gjithë modelit dhe sistemit të funksionimit përmes teknologjive digjitale për t'i shërbyer më mirë përdoruesve dhe për të optimizuar proceset.

Digjitalizimi dhe futja e mundësive për mësimdhënie dhe komunikim online ndërmjet IAL-ve dhe studentëve nënkupton investim në cilësi të barabartë, apo edhe më të lartë të shërbimeve dhe mësimdhënies, sepse disa kërkime dhe analiza³ treguan mosbesim në procesin e digjitalizimit pikërisht për shkak të cilësisë së pamjaftueshme të mësimin online dhe procedurave administrative gjatë krizës me koronën.

Ideja për këtë analizë lindi nga përvoja e të rinjve që ndërveprojnë me institucionet e arsimit të lartë në Maqedoninë e Veriut. Mungesa e transformimit digjital prek të gjithë studentët e vendit, si në universitetet publike ashtu edhe ato private. Për shkak të faktit se universiteti më i madh dhe më i vjetër në vend “Shën Kirili dhe Metodi” – Shkup, por edhe pjesa tjetër e universiteteve nuk kanë sistem plotësisht funksional të digjitalizuar për shërbimet e tyre, gjegjësisht vazhdimisht i përshtatin shërbimet e tyre të digjitalizuara dhe mësimin në distancë, studentët dhe të rinjtë detyrohen të kalojnë nëpër sërë procedurash që zgjasin me orë të tëra dhe universitetet mbeten prapa trendeve botërore, gjë që ndikon në cilësinë e mësimdhënies dhe në rënien e renditjes botërore të institucioneve cilësore të arsimit të lartë.

- 1 Mund të lexoni më shumë rreth termit “digjitalizim” dhe çfarë mbulon ai këtu : <https://www.gartner.com/en/information-technology/glossary/digitalization>
- 2 Sistemet cloud (re) përfshijnë, ndër të tjera, shpërndarjen e shërbimeve të hostuara (nikoqire) përmes internetit, si ruajtja e të dhënave, përpunimi dhe analiza e të dhënave, etj.
- 3 Më shumë në: Тренеска, Ј. (2022). „Дигитализација на високо образование – предизвици и можности“: <https://mof.mk/wp-content/uploads/2022/04/Digitalizatsija-na-visokoto-obrazovanie-Predizvitsii-mozhnosti.pdf> (qasur më 01.02.2023); Петреска, Н. et al. (2021). „Анализа на квалитетот на високото образование во Република Македонија. Перцепциите на професорите и студентите“: <http://manu.edu.mk/%D0%BD%D0%BD%D0%BD%D0%B8%D0%B7%D0%BD-%D0%BD%D0%BD%D0%BA%D0%B2%D0%B0%D0%BB%D0%B8%D1%82%D0%B5%D1%82%D0%BE%D1%82-%D0%BD%D0%BD%D0%B2%D0%B8%D1%81%D0%BE%D0%BA%D0%BE%D1%82%D0%BE-%D0%BE%D0%B1%D1%80/> (qasur më 01.02.2023) dhe Ивановска-Илиевска, В. за Македонски институт за медиуми: <https://mim.org.mk/mk/aktivizam/1248-studentite-na-ukim-baraat-digitalizacija-rektorskata-uprava-na-javuva-progres-za-modernizacija-treba-da-se-menuvaat-zakoni> (qasur më 01.02.2023).

“ Transformimi digjital sjell kursim kohe. Mos të ketë nevojë për të shkuar në bankë, pastaj në zyrën për çështje studentore. Automatizim, pa faktor njerëzor. Edhe të jetë pa gabime, për shkak të të cilave procedura duhet të përsëritet, pra studentët të duhet të përsërisin të gjithë procesin. Do të kursejmë kohë dhe do të kemi një qasje më të thjeshtë. Se nuk ka shqetësime dhe pritje në radhë, ky është faktori më i rëndësishëm”.

Sllavço Temelkovski, kryetar i Asamblesë Studentore Universitar të UKIM – Shkup.

të digjitalizojnë një pjesë të proceseve të brendshme operationale, por nevojiten zgjidhje dhe standarde sistematike që do të vendosen në nivel universiteti. për të siguruar përputhshmëri cilësore të shërbimeve dhe të mësimdhënies. Në një kohë kur shumica e industrive të tjera kanë ndërtuar sistem të avancuar komunikimi dhe shërbimesh digjitale për konsumatorët, është e kuptueshme që edhe studentët kanë nevojë dhe presin procedura të thjeshta, të personalizuar, shërbime të automatizuara dhe një sistem të “vetë-shërbimit” në arsim. Për të lulëzuar në të ardhmen, institucionet e arsimit të lartë duhet të përqafojnë dhe përshejtojnë procesin e transformimit digjital për të optimizuar operationet dhe shërbimet për të përmirësuar përvojat e studentëve dhe për të zgjeruar shtrirjen e tyre. Kjo do të kontribuojë njëkohësisht në uljen e shpenzimeve dhe kohës, si për institucionet ashtu edhe për studentët.

Edhe pse transformimi digjital ka qenë në rendin e ditës për më shumë se një dekadë, pandemia e shkaktuar nga virusi Covid-19 e përshpejtoi këtë dinamikë, por gjithashtu theksoi nevojën për veprim urgjent. Edhe me digjitalizimin e përshpejtuar të detyruar dhe futjen e mësimdhënies online gjatë pandemisë, nuk u vendos një zgjidhje sistematike dhe strategji e qartë për digjitalizimin e plotë të arsimit të

“ Arsyeya e parë pse nevojiten shërbimet digjitale është ulja e shpenzimeve të udhëtimit të studentëve që nuk vijnë nga qyteti ku ndodhet universiteti. Më pas, shërbimet digjitale do të mundësojnë certifikim më të lehtë dhe më të shpejtë semestral, regjistrim semestral, por edhe regjistrim në provime. Në këtë mënyrë do të kursejnë edhe kohë.

Eva Miteva, kryetare e Asamblesë të studentëve të Fakultetit për Shkenca Kompjuterike në Universitetin e Shkencave të Aplikuara – Shtip.

Në epokën e teknologjisë së avancuar, studentët kanë nevojë për administrim dhe procedura të digjitalizuara, regjistrim online për provime, baza të të dhënave online, indekse elektronike. Disa nga fakultetet po përpiqen në mënyrë të pavarur të prezantojnë shërbime të reja digjitale, mësimdhënie online ose të kombinuara me prezencë fizike, ose

Edhe pse është hapur mundësia e regjistrimit online të provimeve në sistemin *iKnow*⁴, megjithatë, një pjesë e madhe e procedurave administrative dhe materialeve mësimore janë kryesisht në dispozicion dhe të përdorura në formë të shtypur. Në të njëjtën kohë, metodat e mësimdhënies janë nga disa dekada më parë dhe shpesh nuk për-

4 Iknow – aplikacion, ose sistem me procese administrative studentore të digjitalizuara dhe shërbime të fakulteteve në kuadër të Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi” – Shkup, që nisi të zbatohet më shumë se pesë vjet më parë. Përdoruesit përmes këtij aplikacioni mund të kryejnë rishikimin e njoftimeve, të dhënave personale, semestrave të regjistruar, lëndëve, raporteve dhe provimeve, dhe u mundësohet edhe të regjistrojnë semestër të ri, të zgjedhin lëndë, të regjistrojnë provimet për një seancë të caktuar provimesh.

puthen me tendencat e reja, si dhe me tendencat e mësimdhënies në distancë.⁵ Pandemia e Covid-it hapi edhe çështje që lidhen me nevojën për ndryshime ligjore që do të mundësojnë digjitalizimin e mësimdhënies dhe arsimit të lartë, si rregullimi i nënshkrimeve elektronike për diploma, arkivim të dokumentacionit që tashmë është i detyrueshëm të ruhet për 50 vjet në formë të shtypur, etj.

Transformimi digjital ofron

shumë mundësi për inovacion, por kërkon gjithashtu që universitetet të zhvillojnë infrastrukturë të re IT dhe të përmirësojnë aftësitë digjitale të personelit. Kjo kërkon përshtatjen e politikave të financimit të universiteteve në përputhje me nevojat e reja, si dhe krijimin e një strategjie shtetërore efikase për digjitalizimin e arsimit të lartë me synime, udhëzime, hapa dhe tregues të qartë. E gjithë kjo kërkon mbështetje financiare nga shteti, si dhe vullnet politik për ndryshime të përshtetura të nevojshme ligjore.

Transformimi digjital i mësimdhënies dhe shërbimeve në arsimin e lartë nuk nënkupton vetëm aplikimin e teknologjive digjitale në arsim, por parashikon edhe integrim të thellë të teknologjive digjitale në arsim. Përveç kësaj, për të zbatuar një proces të suksesshëm të transformimit digjital, është e nevojshme që të gjithë të përfshirë dhe të prekur të kenë një nivel të caktuar aftësish digjitale. Aftësitë digjitale përkufizohen si gamë e aftësive për të përdorur pajisjet digjitale, si dhe aplikacionet dhe rrjetet e komunikimit për të qasur dhe menaxhuar informacionin. Ato u mundësojnë njerëzve të krijojnë dhe të ndajnë përmbajtje digjitale, të komunikojnë dhe bashkëpunojnë dhe të zgjidhin probleme që do të kontribuojnë në mësimin efektiv, punën dhe aktivitetet sociale.⁶

Këto aftësi TIK duhet të përmirësohen vazhdimisht, prandaj nevojiten trajnime për të gjithë të përfshirë në zbatimin e shërbimeve digjitale dhe mësimdhënien në universitete, nga administrata e universitetit deri te përdoruesit e shërbimeve digjitale, nga njëra anë, si dhe trajnimi i personelit të përshtatshëm të TI-së i cili do të zbatojë, mirëmbajë dhe përmirësojë sistemin universitar. Qëllimi i transformimit digjital është që studentët të fitojnë më shumë autonomi në të nxënit e tyre dhe IAL-të të zhvillojnë programe më cilësore që do të reformojnë dhe revolucionarizojnë modelet tradicionale të mësimdhënies në arsim të lartë dhe do të krijojnë modele të reja të përshtatshme me epokën digjitale.

Derisa teknologjitë e reja ecin përpara, digjitalizimi përfshihet në to. Për mendimin tim, segmenti më i rëndësishëm ku duhet të përfshihet digjitalizimi janë mjetet mësimore digjitale, të cilat në fakt do ta bëjnë procesin mësimor më cilësor dhe studentët do t'i përvetësojnë më lehtë përmbajtjet mësimore.

Kjo është gjëja e parë që është shumë domethënëse. E dyta, është indeksi elektronik, që do të thotë se studentët nuk duhet të jenë të pranishëm gjatë regjistrimeve të semestrave, në paraqitjen e kërkesave, peticioneve dhe të të gjitha llojeve të dokumenteve.

prof. Hristina Spaseska, prorektore për mësimdhënie, UKIM – Shkup.

5 Më shumë në Тренеска, Ј. (2022). „Дигитализација на високото образование – предизвици и можности“: <https://mof.mk/wp-content/uploads/2022/04/Digitalizatsija-na-visokoto-obrazovanie-Predizvitsii-mozhnosti.pdf> (qasur më 01.02.2023).

6 UNESCO-s. (2022). "Aftësi digjitale thelbësore për punë dhe punë të ardhshme": <https://www.unesco.org/en/articles/digital-skills-critical-jobs-and-social-inclusion> (qasur më 1 shkurt 2023).

Transformimi digjital është gjithashtu i nevojshëm për shkak të përputhshmërisë me politikat dhe praktikën e Bashkimit Evropian. Në vitin 2021, Bashkimi nisi një iniciativë për modernizimin e arsimit dhe digjitalizimit “për të mbështetur një përshtatje të qëndrueshme dhe efektive të sistemeve të arsimit dhe trajnimit të Shteteve Anëtare të BE-së në epokën digjitale”.⁷ Prandaj, qëllimi i kësaj analize është të shërbejë si një dokument bazë, gjithëpërfshirës mbi të cilin do të planifikohen hapat e ardhshëm të këtij procesi kompleks të digjitalizimit të arsimit të lartë.



7 Komisioni Evropian – Plani i Arsimit Digjital 2021 – 2027: <https://education.ec.europa.eu/focus-topics/digital-education/action-plan> (qasur më 01/02/2023).

2. Sfidat dhe pengesat në transformimin digjital të institucioneve të arsimit të lartë

Për qëllimet e këtij dokumenti, dhe bazuar në gjetjet nga takimet dhe intervistat, i grupojmë sfidat dhe barrierat në shtatë fusha kryesore:

I. Sistemi informativ i vjetërsuar

Tre universitetet që janë objekt i kësaj analize përdorin sisteme informacioni të trashëguara që janë të vjetruara dhe të papërshtatshme për t'u përdorur në kontekstin e digjitalizimit. Shpesh këto sisteme të vjetra nuk ofrohen ose integrohen siç duhet për të ofruar mbështetjen dhe funksionimin e nevojshëm për të përmirësuar proceset e biznesit dhe për të përmirësuar përvojën e përdoruesit përfundimtar. Bashkëbiseduesit nga universitetet theksojnë se procesi i digjitalizimit në to ka nisur 15 vjet më parë dhe vazhdimisht investojnë në përmirësimin e sistemeve.

II. Mungesa e IT mbështetjes dhe menaxhimit

UKIM, UGD dhe UEJL përballen me sfida gjatë transformimit digjital sepse nuk kanë menaxhim të formalizuar me teknologjitë informative nga ana e rektorëve, pra ju mungon struktura që siguron përdorimin efikas të teknologjisë informative për të mbështetur qëllimet e organizatës/institucionit. Në të njëjtën kohë, zgjidhjet e personalizuara të TI-së janë shumë të vështira për t'u kryer në kohën e duhur dhe me buxhet të kufizuar. Për më tepër, këto procese dhe softuer të personalizuar të digjitalizimit kërkojnë mirëmbajtje dhe mbështetje të shtrenjtë. Sfidë tjetër paraqet edhe tërheqja dhe mbajtja e personelit të aftë të nevojshëm për të zbatuar dhe mbështetur

Është thelbësore të kemi njerëz dhe infrastrukturë. Nuk mund të flasim për digjitalizim nëse nuk kemi njerëz që mund ta zbatojnë digjitalizimin. Sektori i IT-së është konkurrues. Kjo reflektohet edhe në funksionimin e institucioneve të arsimit të lartë. Është proces i shtrenjtë. Infrastruktura e TI-së po ndryshon dhe është e shtrenjtë. Duhet të fillojë në kohën e duhur dhe gradualisht të përmirësohen pajisjet që në fund të kemi një universitet digjital.

prof. Mishko Gjdrov,
prorektor për mësimdhënie, UGD – Shtip.

Për digjitalizim cilësor, është e rëndësishme të kemi burime dhe pajisje teknike cilësore. Digjitalizimi e kërkon këtë, pavarësisht nëse bëhet fjalë për kompjuterë apo rrjet optik. Sigurisht që duhet edhe buxhet serioz për zbatim, sepse teknologjitë ndryshojnë, diçka që ishte tërheqëse 5 vite më parë, tashmë është vjetërsuar. Ajo që është shumë e rëndësishme është që personeli teknik, pedagogët, madje edhe studentët të kenë mbështetje serioze teknike. Është shumë e rëndësishme që të gjitha shërbimet profesionale madje edhe profesorët të kenë trajnime të vazhdueshme për teknologjitë e reja. Këto janë kushtet që bëjnë dallim të madh nëse sistem i tillë jo vetëm të futet, por edhe të përdoret.

prof. Hristina Spasevska, prorektore për mësimdhënie, UKIM – Shkup.

teknologjitë e nevojshme për transformimin e institucionit. Departamentet tipike të TI-së në IAL shpesh përballen me personel dhe financim të pamjaftueshëm. Për shkak të burimeve të kufizuara, janë të detyruar të përshtaten me zgjidhjet ad hoc (si në rastin e pandemisë Covid) në vend që të zhvillojnë strategji digjitale që do të avancojnë institucionin. Prandaj, përkushtimi i institucionit për zbatimin dhe menaxhimin e ndryshimeve, si dhe vlerësimi i rëndësisë së përshtatjes me mënyrën e re të funksionimit, është kyçe për suksesin e të gjithë procesit.

III. Vështirësia për të pranuar ndryshime (faktori njerëzor)

Në një pjesë të madhe të takimeve dhe intervistave u vu në dukje qartë se aftësitë digjitale të një pjese të personelit të universitetit (kryesisht, zyrtarëve të administratës dhe profesorëve) mbeten prapa pjesës tjetër të aftësive. Përveç kësaj, njerëzit në përgjithësi zgjedhin të zbatojnë atë që tashmë dinë të bëjnë dhe nuk duan të dalin nga zona e tyre e rehatisë, gjë që ndikon në zbatimin e ngadaltë të procesit të dig-

jitalizimit. Gjithashtu, në arsim ka shumë frikë nga dështimi dhe dyshohet nëse është më mirë të mësohen aftësi apo procese të reja dhe në qoftë se përshtaten me teknologjinë, kulturën apo mentalitetin e ri a do të jenë të suksesshëm ose jo.

Rezistencën më të madhe e japin shërbimet profesionale. Ato janë mësuar me sistemet ekzistuese. Duan të vazhdojnë të përdorin atë që kanë përdorur. Pavarësisht nëse është e vjetërsuar dhe e vështirëson punën e tyre.

prof. Hristina Spasevska,
prorektore për mësimdhënie,
UKIM - Shkup.

Rezistencën më të madhe e japin profesorët e moshës më të thyer të cilët vlerësojnë se digjitalizimi është i ndërlikuar. Ka rezistencë dhe kundërshtim për të mos dalë nga zona e rehatisë. Sigurisht, ka edhe përjashtime.

Slavčo Temelkovski,
president i AUS UKIM..

IV. Mungesa e aftësive të nevojshme

Një nga problemet që u zbuluan është personeli i pamjaftueshëm, personeli i trajnuar në mënyrë të papërshtatshme dhe mungesa e fondeve për transformim digjital në nivele të shumëfishta – si për sa i përket burimeve njerëzore dhe trajnimit, ashtu edhe sigurimit të teknologjisë. Vetëm një pjesë e institucioneve kanë burimet e nevojshme për të tërhequr dhe mbajtur personel cilësor të IT-së që nevojitet për transformime digjitale ambicioze. Për një digjitalizim të suksesshëm, është e nevojshme që të gjithë të përfshirët në proces të kenë nivel të caktuar të aftësive dhe ekspertizës së TIK-ut dhe kjo duhet të përmirësohet vazhdimisht.

Sfidë shtesë mjaftë e madhe është fakti se qytetarët e Maqedonisë janë dukshëm prapa bashkëmoshatarëve të tyre nga BE-ja në aspektin e aftësive digjitale, si dhe përdorimin e aftësive digjitale në jetën e përditshme dhe në punë. Të dhënat krahasuese tregojnë se niveli i aftësive digjitale të popullatës maqedonase është relativisht i ulët.

Sipas Eurostat, vetëm 35% e popullsisë në vitin 2021 zotëronte nivelin bazë ose mbi nivelin bazë të aftësive digjitale krahasuar me 54% të popullsisë në shtetet anëtare të BE-së. Kroacia dhe Estonia janë vendet me nivel më të lartë të digjitalizimit, ndërsa vendet e rajonit kanë nivel më të ulët të aftësive digjitale në krahasim me mesataren e BE-së. Në periudhën 2019-2021, përqindja e qytetarëve me nivel bazë ose mbi nivelin bazë të aftësive digjitale është rritur për 3 pikë përqindje.⁸

V. Burimet financiare të ndara në mënyrë të pamjaftueshme

Nevoja për të investuar në burime, personel dhe aftësi është një nga arsytet e shkallës së ndryshme të transformimit digjital të IAL-ve në Maqedoni. Vetë universitetet, por edhe institucionet qeveritare, nuk ofrojnë strategji të zbatueshme dhe mbështetje financiare të unifikuar dhe gjithëpërfshirëse për të mbështetur këtë proces në arsimin e lartë. Njëkohësisht, është inkurajuese që të gjithë të intervistuarit gjatë përgatitjes së këtij dokumenti theksuan qartë se e kuptojnë rëndësinë dhe punojnë për zbatimin e transformimit digjital brenda mundësive dhe kompetencave të tyre. Në të njëjtën kohë, të anketuarit konkluduan se për të arritur digjitalizim të suksesshëm dhe të qëndrueshëm, nevojitet investim i burimeve financiare, por edhe se një investim i tillë kthehet shumë shpejt dhe shpërblehet në planin afatgjatë.

Universiteti po përmirëson sistemet me fondet e veta. Por nëse shteti ka vizion, nëse vendos të zbatojë një proces digjitalizimi afatgjatë, mbështetja financiare nga ministrinë tona do të thoshte shumë për ne. Do të na japë më shumë liri për t'u zhvilluar në drejtimet që duam.

prof. Mishko Gjdrov, prorektor për mësimdhënie, UGD – Shtip.

Së pari, qëllimi i transformimit digjital është që të mos ketë burokraci dhe dokumente, por që të gjitha proceset e brendshme të zhvillohen më lehtë. Së dyti, qasja ndaj studentëve, komunikimi formal dhe joformal do të lehtësohet shumë. E treta, dhe ndoshta gjëja më e rëndësishme, në këtë mënyrë shpenzimet do të reduktohen. Më pak përpjekje, më pak orë për të bërë të njëjtën gjë

Adrian Besimi, prorektor për planifikim akademik dhe digjitalizim në Universitetin e Evropës Juglindore – Tetovë.

8 Македонија 2022. 2025. „Колку Македонија и Македонците се „дигитални“: <https://ekonomikaibiznis.mk/News.aspx?IdNews=26175> (qasur më 01.02.2023).

VI. Mungesë ose strategji dhe plane veprimi të papërshtatshme për digjitalizim

Një nga pengesat kryesore të progresit është mungesa e një strategjie gjithëpërfshirëse, domethënë udhëzimeve specifike dhe të qarta se si të zbatohet dhe përmirësohet transformimi digjital në çdo sektor apo industri, përkatësisht në arsim. Është e një rëndësie të veçantë që të parashikohen veprime operacionale për zbatimin e strategjive të tilla, pra, çdo Strategji e Transformimit Digjital duhet të pasohet nga plane specifike veprimi që përmbajnë tregues të qartë të performancës, afate, persona përgjegjës për proceset, etj.

VII. Mospranimi i kërkesave dhe mosplotësimi i pritshmërive të studentëve

Sistemet e TI-së duhet të përshtaten me nevojat në ndryshim të studentëve dhe rregulloreve. Nëse institucionet nuk janë të përkushtuara për të ndryshuar menaxhimin, ato mund të përjetojnë transformime digjitale të dështuara. Dhe, një nga pritshmëritë dhe kërkesat më të mëdha të studentëve është përshtatja e shpejtë me ndryshimet në shoqëri, duke përfshirë zbatimin e një transformimi efikas digjital të të gjitha IAL-ve, i cili do të fokusohet njësoj si në pjesën e mësimdhënies, ashtu edhe në shërbimet që universitetet ofrojnë.

“ Nga përvoja që kam deri tani, mendoj se fakulteti im dhe universitetet e tjera mund të transformohen në mënyrë digjitale, por të gjithëve u mungon vullneti. Menaxhmenti ka njëfarë kompetence në Ligjin për Arsim të Lartë për të bërë ndryshime, por shohim që 3 vite pas pandemisë dhe shumë vite më parë, nuk është bërë asnjë hap konkret, përveç atyre deklarative, për digjitalizimin e disa mjeteve dhe shërbimeve. Shpresoj që testamenti të gjendet në vitet e ardhshme. Është për të ardhur keq që në vitin 2023 po mendojmë sikur të jemi në shekullin e 20-të.

Blendi Hodai, student i UKIM dhe kryetar i organizatës civile “Forumi për Ndryshime Arsimore”.

3. Përfundimet e analizës

Nga intervistat me të anketuarit dhe desk hulumtimi i kryer, mund të nxirren përfundimet e mëposhtme:

- >>> Digjitalizimi nuk është më një çështje për të cilën duhet menduar se “a kemi nevojë për të ose jo”, por paraqet një domosdoshmëri,** veçanërisht nëse duam që universitetet në vend të mos mbeten prapa IAL-ve në rajon dhe në nivel global, dhe studentët të shohin jofleksibilitetin si një nga arsyet për studime jashtë universiteteve maqedonase të disa prej IAL-ve në vend, duke përfshirë procedurat e ndërlikuara burokratike me dokumentet dhe pamundësinë për të marrë informacion të shpejtë dhe online për mësimdhënien si materiale, mësim, etj.
- >>> Universiteteve u mungojnë platforma digjitale gjithëpërfshirëse dhe aplikacione profesionale të licencuara që do të përditësohen rregullisht dhe do të jenë në dispozicion për të gjithë:** Gjatë digjitalizimit nevojitet investime në kompjuterë dhe pajisje të tjera, internet cilësor dhe veçanërisht për t'u siguruar që ato të jenë të qasshme për të gjithë. Transformimi digjital nuk duhet të kthehet në privilegj, por është e nevojshme të ofrohen mundësi për çdo person të përfshirë në procesin e arsimit të lartë.
- >>> Studentët e universiteteve të synuara që përdorin shërbimet digjitale ekzistuese janë të kënaqur me përvojat:** Sipas përvojave të universiteteve/fakulteteve që kanë prezantuar digjitalizimin e shërbimeve (edhe pse niveli në të tre universitetet e analizës është i ndryshëm), sipas të anketuarit, kënaqësia e studentëve është në nivel shumë më të lartë, burokratizimi, shpenzimi i kohës dhe burimeve financiare është reduktuar në minimum, dhe andaj mbetet hapësirë dhe kohë e cila përdoret për të investuar në cilësi shtesë të proceset e mësimdhënies dhe të të nxënit.
- >>> Profesorët mbështesin mësimin me prani fizike, studentët preferojnë hibrid:** Për këtë pyetje, mendimet e të anketuarve ishin mjaft të ndara. Personeli pedagogjik preferon mënyrën tradicionale të të mësuarit, me prani fizike dhe dhënie e provimeve, ndërsa nga ana tjetër, studentët preferojnë mundësi për mësimdhënie hibride që do t'u japë mundësinë për të organizuar kohën, përgjegjësitë e tyre, por edhe për t'u garantuar lëvizshmërinë që është veçori e kohës së globalizimit dhe mundësive që ofrohen në këtë periudhë kohore. Gjithashtu, disa nga të anketuarit theksuan se mundësia e mësimdhënies online ose hibride është e rëndësishme për një pjesë të studentëve, pasi nuk u krijon barrë buxhetit. Gjithashtu, disa nga të anketuarit theksuan mbingopjen e të mësuarit dhe komunikimit online, si dhe mungesën e ndërveprimit social, veçanërisht gjatë mësimin online në pandeminë me Covid-19.
- >>> Universiteteve të synuara u mungon qasja digjitale në burime dhe botime shkencore:** Të anketuarit pajtohen se qasja në burime dhe botime shkencore përmes kanaleve digjitale është shumë e kufizuar në të gjithë vendin, pavarësisht përpjekjeve të ndryshme nga disa institucione të arsimit të lartë për ta ndryshuar këtë. Për më tepër, në këtë ndikojnë edhe mundësitë e pabarabarta dhe qasja në pajisje IT dhe internet cilësor nga studentët.

4. Rekomandime për transformim digjital të suksesshëm të institucioneve të arsimit të lartë



I. Rekomandime për institucionet e arsimit të lartë dhe menaxhmentin e tyre, profesorët dhe zyrtarët administrativë të përfshirë në analizë

- > Institucionet e arsimit të lartë (IAL) duhet tu përshtaten shpejt kushteve e krizës dhe të përshtatin shërbimet që u ofrojnë studentëve, mënyrën e mësimdhënies, si dhe komunikimin dhe koordinimin e brendshëm ndërmjet punonjësve.
- > IAL-të duhet të investojnë në infrastrukturën e rrjetit, programe dhe softuer të licencuar, kompjuterë dhe pajisje të tjera.
- > IAL-të duhet të investojnë burimet e tyre në sisteme transformimi dhe zbatim digjital dhe mund të shfrytëzohen mundësitë për grante dhe donacione nga donatorë vendas dhe të huaj.
- > IAL-të duhet të stimulojnë punonjësit për të përmirësuar aftësitë e tyre digjitale dhe të investojnë në trajnimin e personelit për të rritur aftësitë e tyre digjitale.
- > IAL-të duhet të investojnë në sigurinë kibernetike: të dhënat personale dhe të gjitha informacionet duhet të mbeten të sigura, përndryshe, besimi në proces do të shkelet, gjë që do të ngadalësojë më tej të gjitha përpjekjet dhe investimet e mëparshme.
- > Institucionet e arsimit të lartë duhet të ofrojnë qasje më të mirë në revistat moderne shkencore dhe kërkimin shkencor për studentët.
- > IAL-të duhet të prezantojnë mundësinë e monitorimit të analizës së të dhënave të kënaqësisë me mësimdhënien dhe shërbimet me qëllim që të reagohet dhe ketë përmirësime në kohë.
- > Universitetet duhet të prezantojnë mjet për të monitoruar progresin e çdo studenti nëse ka nevojë për mbështetje në rast vështirësish në studim, si dhe për të marrë praktika pozitive për studentët e tjerë.
- > Në universitetet e synuara, ku nuk ka, duhet të përdoret indeksi elektronik, pa procedurë shtesë në letër.
- > Universitetet duhet të prezantojnë sistem të pagesave online dhe paraqitjes së kërkesave, si dhe të modernizojnë faqet e tyre të internetit që duhet të ofrojnë përvojë të mirë përdoruesi.
- > IAL-të duhet të ofrojnë kompensim financiar motivues për të mbajtur personelin e IT-së: disa nga të anketuarit theksuan nevojën për kompensim financiar në mënyra të ndryshme për personat kryesorë të IT-së që do të koordinojnë procesin e transformimit digjital, pavarësisht nëse bëhet fjalë për personelin mësimor nga fakultetet për shkenca kompjuterike ose ekspertë dhe kompani të jashtme të TI-së.

- > Institucionet e arsimit të lartë duhet të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe të lidhen në rajon: disa nga të anketuarit kanë theksuar nevojën për t'iu bashkuar institucionet e arsimit të lartë maqedonas në kuadër të iniciativave si Ballkani i Hapur, Procesi i Berlinit, Karta A5 e Adriatikut⁹ dhe të ngjashme. Universitetet dhe organizatat studentore maqedonase duhet të bashkohen rreth nevojës për transformim digjital në arsimin e lartë dhe të iniciojnë zbatimin dhe bashkëpunimin e përbashkët të këtij plani me IAL-të nga rajoni. Në këtë proces është e nevojshme përfshirja e institucioneve kompetente, e cila pritet të ndërtojë sinergji shtesë dhe t'i japë shtysë rrjetëzimit dhe bashkëpunimit ndërmjet të gjithë aktorëve socialë në këtë pjesë.



II. Rekomandime për studentët dhe organizatat studentore nga universitetet e synuara

- > Organizatat studentore duhet të përfshihen më aktivisht në procesin e digjitalizimit të IAL-ve me propozime dhe aktivitete specifike.
- > Organizatat studentore duhet të ofrojnë edukim të bashkëmoshatarëve ku njohuritë dhe aftësitë do të mund të transferohen te kolegët e tyre që kanë aftësi më të dobëta në përdorimin e mjeteve digjitale.
- > Organizatat studentore duhet të ndërmarrin iniciativa më të mëdha dhe hapa e propozime konkrete për IAL-të dhe institucionet publike kompetente për të nxitur vazhdimisht proceset e digjitalizimit dhe realizimin më të shpejtë të konceptit të transformimit digjital në arsimin e lartë.



III. Rekomandime për qeverinë dhe institucionet kompetente për arsimin e lartë

- > Qeveria dhe institucionet kompetente duhet të ofrojnë mbështetje ligjore dhe të tjera institucionale për digjitalizimin gjithëpërfshirës, uniform dhe të standardizuar të IAL-ve të financuara nga shteti. Institucionet në nivel qendror, para së gjithash Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), por edhe ministritë e tjera, si Ministria e Shoqërisë Informativë dhe Administratës (MShIA) dhe Ministria e Financave (MF), duhet të kenë prioritet digjitalizimin, veçanërisht nëpërmjet unifikimit të mundësive minimale të nevojshme digjitale në arsimin e lartë.
- > Institucionet dhe qeveria duhet të zbatojnë me shpejtësi strategjinë ekzistuese të arsimit (2018–2025) dhe planet e veprimit.
- > Qeveria dhe institucionet duhet të harmonizojnë transformimin digjital me politikat e BE-së në këtë fushë, veçanërisht pas fillimit të proceseve të shqyrtimit dhe harmonizimit të legjisllacionit, si dhe të ofrojnë qasje më të lehtë në mundësitë financiare për të mbështetur transformimin digjital në nivel kombëtar dhe rajonal brenda kuadrit të arsimit të lartë.
- > Pushteti qendror dhe vendor duhet të investojnë në zhvillimin e rrjetit të internetit në zonat rurale për të siguruar qasje në një rrjet të qëndrueshëm interneti për të gjithë. Interneti i institucioneve arsimore duhet të jetë falas, cilësia e tij të jetë

9 Grupi A5 Adriatik do të kryesohet nga Maqedonia e Veriut në vitin 2023, gjë që paraqet një mundësi të shkëlqyer për të dhënë iniciativën e parë për rrjetëzimit dhe bashkëpunim.

e lartë dhe të përdoret në arritjen e qëllimeve të mësimdhënies dhe realizimin më të lehtë të shërbimeve të ofruara nga IAL. Interneti falas në ambientet e të gjitha institucioneve të arsimit të lartë dhe konvikteve studentore do të kontribuojë për cilësi më të lartë të mësimdhënies, shërbime më të mira, e në këtë mënyrë për kënaqësi më të madhe me arsimin e lartë në vend.



Bibliografia dhe dokumentet e përdorur:

Dokumentet publike:

Strategjia e Arsimit 2018-2025 dhe Plani i Veprimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës: <https://mon.gov.mk/page/?id=2048>

Strategjia Kombëtare për TIK 2021 – 2025 <https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=newdocumentdetails&detailid=23>

Të tjera:

Тренеска, Ј. (2022). „Дигитализација на високото образование – предизвици и можности“: <https://mof.mk/wp-content/uploads/2022/04/Digitali-zatsija-na-visokoto-obrazovanie-Predizvitsii-mozhnosti.pdf> (qasur më 01.02.2023)

Петреска, Н. et al. (2021). „Анализа на квалитетот на високото образование во Република Македонија. Перцепциите на професорите и студентите“: <http://manu.edu.mk/%D0%B0%D0%BD%D0%B0%D0%B%D0%http://manu.edu.mk/%D0%B0%D0%BD%D0%B0%D0%B%D0%B8%D0%B7%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D0%BA%D0%B2%D0%B0%BB%D0%B8%D1%82%D0%B5%D1%82%D0BE%D1%82-%D0%BD%D0%B0-%D0%B2%D0%B8%D1%81%D0BE%D0%BA%D0BE%D1%82%D0BE-%D0BE%D0%B1%D1%80/> (qasur më 01.02.2023 d.)

Ivanovska-Ilievska, V. për Institutin Maqedonas për Media: <https://mim.org.mk/mk/aktivizam/1248-studentite-na-ukim-baraat-digitalizacija-rektorskata-up-rava-najavuva-progres-za-modernizacija-treba-da-se-menuvaat-zakoni> (qasur më 01.02.2023)

UNESCO-s. (2022). “Shkathtësitë digjitale kritike për punët dhe punët e ardhshme”: <https://www.unesco.org/en/articles/digital-skills-critical-jobs-and-social-inclusion> (qasur më 01/02/2023).

Komisioni Evropian – Plani i Arsimit Digjital 2021 – 2027: <https://education.ec.europa.eu/focus-topics/digital-education/action-plan> (qasur më 01/02/2023).

Македонија 2025. 2022. „Колку Македонија и Македонците се „дигитални“: <https://ekonomimaibiznis.mk/News.aspx?IdNews=26175> (qasur më 01.02.2023)

Shtojca I: intervista të thelluara të realizuara

Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi”, Shkup

- > Prof. Dr. Hristina Spasevska, prorektore për mësimdhënie
- > Sllavčo Temelkovski, president i AUS
- > Blendi Hodai, student dhe kryetar i FOP Tetovë

Universiteti i EJL, Tetovë

- > Prof. Adrian Besimi, Prorektor për Planifikim Akademik dhe Digjitalizim
- > Demir Demiri, president i AUS
- > Ron Ismaili, student në Universitetin e EJL

Universiteti “Goce Dellçev”, Shtip

- > Prof. Dr. Mishko Gjdrov, prorektor për mësimdhënie
- > Sara Denkova, presidente e AUS
- > Eva Miteva, kryetare e FSS për shkencat kompjuterike

Intervistat janë realizuar në periudhën janar-shkurt 2023.

